Përvoja dhe cilësia në mësimdhënie: Kandidati dëshmon përvojë të gjatë dhe të vazhdueshme në arsimin e lartë. Sipas dokumentacionit të paraqitur, aktiviteti mësimor përfshin angazhime në Universitetin "Haxhi Zeka", Universitetin e Prishtinës, Kolegjin UBT dhe IBCM. Vetëm në kategorinë e përvojës relevante të mësimdhënies, formulari evidenton 11 pikë, përfshirë gjashtë vite si Profesor Asistent dhe katër vite, 2022-2026, si Profesor i Asociuar në Fakultetin e Biznesit të UHZ-së. Cilësia e mësimdhënies mbështetet gjithashtu nga vlerësimet e studentëve. Për tri vitet e fundit akademike kandidati ka arritur vlerësimet 4.54, 4.31 dhe 4.48, përkatësisht një mesatare prej 4.44, duke dëshmuar nivel të lartë të cilësisë dhe vlerësim pozitiv të punës së tij mësimore.

Gjatë karrierës universitare, kandidati ka ligjëruar një gamë të gjerë lëndësh, ndër të cilat veçohen Lidhshpi, Menaxhimi i Projekteve, Menaxhimi i Avancuar i Projekteve, Menaxhimi Strategjik, Menaxhimi Strategjik i Burimeve Njerëzore, Mjedisi Biznesor Ndërkombëtar, Ekonomia Ndërkombëtare dhe Ndërmarrësia, çka dëshmon përputhshmëri të qartë të përvojës së tij mësimore me lëndët e konkursit.

Mentorimi dhe zhvillimi akademik i studentëve: Një komponent veçanërisht i rëndësishëm i veprimtarisë akademike të kandidatit është mentorimi. Dokumentacioni paraqet një numër të konsiderueshëm të mentorimeve të studentëve, kryesisht në nivelin Master, por edhe në nivelin Bachelor, të përfunduara ose në proces. Për këtë kategori, të dhënat e dokumentuara në formular dëshmojnë angazhim të konsiderueshëm dhe të vazhdueshëm në udhëheqjen akademike të studentëve, zhvillimin e kapaciteteve të tyre kërkimore dhe përgatitjen e gjeneratave të reja të profesionistëve dhe studiuesve. Pika 1.6 e paragrafit "g" sipas konkursit është konform Rregullores nr. 2863, date 03.10.2023 për Plotësim ndryshimin e rregullores nr. 025/23.

Publikimet dhe veprimtaria kërkimore-shkencore: Prof. Asoc. Dr. Ibrahim Krasniqi ka zhvilluar aktivitet të gjerë publikues në fusha që ndërlidhen drejtpërdrejt me profilin e tij akademik dhe lëndët e konkursit. Dokumentacioni i paraqitur evidenton publikime shkencore në revista dhe

konferenca ndërkombëtare, përfshirë punime të indeksuara në Scopus, si dhe publikime të tjera relevante akademike.

Vepërtaria shkencore trajton tema të tilla si lidershipi dhe vendimmarrja, menaxhimi strategjik, zhvillimi ekonomik, menaxhimi i projekteve, menaxhimi dhe valorizimi i resurseve, ekonomia qarkore, qëndrueshmëria dhe politikat publike.

Monografi dhe literatura akademike: Kandidati ka kontribuar gjithashtu në literaturën akademike përmes librave, monografive dhe kapitujve të librave. Në dokumentacion evidentohet, ndër të tjera, libri akademik "Menaxhimi i Avancuar i Projekteve" (2026), monografia e botuar në Gjermani mbi menaxhimin strategjik të resurseve energjetike, libri mbi menaxhimin e mbeturinave dhe politikat publike, si dhe kapitulli i librit i botuar në kuadër të serisë së Springer/NATO Science for Peace and Security. Për kategorinë e librave, monografive dhe kapitujve të librave formulari evidenton 3.50 pikë.

Aktiviteti në konferenca dhe komunikimi shkencor: Kandidati ka dëshmuar pjesëmarrje të vazhdueshme në konferenca, kongrese, simpoziume dhe aktivitete të tjera shkencore, si në Kosovë ashtu edhe jashtë vendit.

Vetëm gjatë viteve të fundit dokumentohen prezantime në aktivitete ndërkombëtare në Turqi, Spanjë dhe Kosovë, përfshirë International Balkans Cooperation Congress 2026, IConSoS 2025, ICRESS 2025, ICSETS 2025 dhe konferenca të tjera ndërkombëtare.

Tematikat e prezantuara përfshijnë lidershipin dhe vendimmarrjen, menaxhimin dhe valorizimin e resurseve, ekonominë qarkore, zhvillimin e qëndrueshëm dhe çështje të tjera bashkëkohore të menaxhimit dhe zhvillimit ekonomik.

Projektet kërkimore dhe të aplikueshme: Profili i kandidatit karakterizohet edhe nga një lidhje e fuqishme ndërmjet kërkimit akademik dhe zbatimit praktik të njohurive. Formulari dokumenton angazhimin në dhjetë projekte dhe iniciativa kërkimore/të aplikueshme, me role si koordinator projekti, koordinator akademik, mentor, trajner, anëtar i ekipit implementues, konsulent dhe vlerësues.

Ndër projektet e evidentuara përfshihen "Circular Tourism Pathways: Integrating Circular Economy Principles for Sustainable Tourism Development in the Dukagjini Region" (2026-2027), projekti "Inovacioni, Zhvillimi i Projekteve dhe Startup-Idetë", projekti ndërkombëtar TEMPUS, EUFORIA, RESITA Network, projekti "Circular Economy in Emerging Economies: Pathways to Sustainable Development", aktivitetet mbi ESG dhe Green Loans me FINCA Kosovo, Project Cycle Management me UNDP Kosovo dhe Social Contract Activity me USAID/Democracy International. Për këtë kategori natyra dhe diversiteti i projekteve dëshmojnë aftësinë e kandidatit për të integruar kërkimin shkencor, menaxhimin e projekteve, zhvillimin e qëndrueshëm dhe bashkëpunimin ndërkombëtar.

Ndërkombëtarizimi, mobilitetet dhe aktivitetet profesionale: Një ndër dimensionet më të theksuara të profilit akademik të kandidatit është ndërkombëtarizimi. Dokumentacioni përmban një numër të madh mobilitetesh akademike, ligjëratash, trajnimesh, punëtorish dhe vizitash studimore, për të cilat formulari evidenton 28 pikë.

Në periudhën e fundit veçohen mobiliteti akademik dhe ligjëratat në Universitetin e Sofjes "St. Kliment Ohridski", ligjëratat në kuadër të UNIWIN dhe UNISUM, Public Lecture mbi ESG në Universitas Muhammadiyah Yogyakarta, Indonezi, mobiliteti CEEPUS në Universitetin Europian të Tiranës, mobiliteti akademik në Ludovika University of Public Service në Budapest, si dhe mobiliteti CEEPUS në Universitetin e Salzburgut. Këto aktivitete, së bashku me bashkëpunimet e

tjera ndërkombëtare, dëshmojnë për një profil akademik të hapur dhe të integruar në rrjetet ndërkombëtare të arsimit të lartë.

Përvoja profesionale dhe kontributi institucional: Profili i kandidatit plotësohet nga një përvojë e gjerë profesionale dhe menaxheriale jashtë mësimdhënies universitare. Dokumentacioni evidenton angazhime profesionale dhe konsulte me UNDP, USAID/Democracy International, Lattanzio Advisory, EPTISA, Swiss Cooperation Office, OSCE dhe institucione të tjera kombëtare e ndërkombëtare.

Kandidati ka ushtruar gjithashtu funksione të larta publike dhe menaxheriale, përfshirë pozitën e Sekretarit të Përgjithshëm në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë, Drejtorit të Departamentit për Strategji dhe Projekte dhe Koordinatorit nacional për sektorët e zhvillimit ekonomik, energjetik, minerar dhe industrial. Kjo përvojë përbën vlerë të shtuar për profilin akademik të kandidatit, pasi mundëson integrimin e njohurive shkencore dhe teorike me përvojën konkrete në menaxhim, politika publike, projekte dhe zhvillim institucional.

Konstatimi përfundimtar:

Pas shqyrtimit të dokumentacionit të paraqitur dhe vlerësimit të veprimtarisë së përgjithshme të kandidatit, Komisioni Vlerësues konstaton se Prof. Asoc. Dr. Ibrahim Krasniqi paraqet një profil të konsoliduar akademik, shkencor, mësimor dhe profesional, me vazhdimësi të dëshmuar në kërkimin shkencor, publikime, mësimdhënie universitare, mentorim, projekte kërkimore dhe të aplikueshme, ndërkombëtarizim dhe kontribut institucional.

Në veçanti, perludha e ushtrimit të thirrjes Profesor i Asociuar nga viti 2022, përvoja e gjatë universitare, vlerësimi i lartë i mësimdhënies nga studentët, numri i konsiderueshëm i mentorimeve, publikimet dhe veprimtaria shkencore, librat dhe monografitë, projektet kombëtare e ndërkombëtare, si dhe mobilitetet dhe ligjëratat në universitete jashtë vendit, dëshmojnë vazhdimësi dhe pjekuri të lartë akademike.

Veprimtaria akademike, kërkimore dhe shkencore e kandidatit është njëkohësisht në përputhje të qartë tematike me lëndët për të cilat është shpallur konkursi – Uidershipi, Menaxhimi i Projekteve, Mjedisit Biznesor Ndërkombëtar dhe Menaxhimi Strategjik i Burimeve Njerëzore.

Duke u bazuar në dokumentacionin e dorëzuar, rezultatet e evidentuara në formularin e vlerësimit dhe përmbushjen e kriterëve përkatëse akademike, shkencore, mësimore dhe profesionale, Komisioni Vlerësues **propozon që Prof. Asoc. Dr. Ibrahim Krasniqi të AVANCOHET në thirrjen akademike PROFESOR I RREGULLT (Prof. Dr.) në Fakultetin e Biznesit të Universitetit "Haxhi Zeqa".**

Komisioni vlerëson se avancimi i kandidatit në thirrjen Profesor i Rregullt mbështetet në një veprimtari të dokumentuar, të vazhdueshme dhe shumëdimensionale akademike e profesionale dhe paraqet një zhvillim të natyrshëm të karrierës së tij universitare.

Nënshkrimet e Komisionit recensues (Kjo rubrikë është e rezervuar për Universitetin):

1. Kryetar Prof. Dr. Bedri Statovci

2. Anëtar Prof. Dr. Ibish Mazreku

3. Anëtar Prof. Dr. Gani Asllani

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
MINISTRIA E ARBIMIT,
SHKENCËS
DHE TEKNOLOGJISË

UNIVERSITETI
"HAXHI ZEKA"
PEJË

FAKULTETI JURIDIK

Nr./Dr./No. 432 Nr./faq./Str./Nr./No. p. 2

Data / Datum / Date: 19.08.2026 Faqe / Page / Page: 1



UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERSITÄT

"HAXHI ZEKA"

UNIVERSITETI "HAXHI ZEKA" - PEJË
Dosja e zgjedhjes/avancimit të stafit akademik

REPUBLIKA E KOSOVËS
MINISTRIA E ARBIMIT,
SHKENCËS
DHE TEKNOLOGJISË

REKTORATI

Nr./Dr./No. 2331 Nr./faq./Str./Nr./No. p. 28

Data / Datum / Date: 24.08.2026 Faqe / Page / Page: 1

RAPORT I KOMISIONIT VLERËSUES PËR ZGJEDHJEN E STAFIT AKADEMIK

Fakulteti:	Juridik
Lëndët për të cilat është shpallur konkursi:	E Drejta Penale - Pjesa e Posaçme (O) 3+1, Klinika Juridike Penale (O) 2+2, Delikuenca e të Miturve (Z) 2+1, Kriminologji me Penologji (O) 3+1
Titulli akademik për të cilin shkruhet raporti:	Prof. dr. ☐ <u>Prof. asoc. dr.</u> ☒ Prof. ass. dr. ☐ Ass. ☐

Komisioni vlerësues:

1.	<u>Kryetar</u>	Prof. Dr. Ismail Zejneli
2.	<u>Anëtar</u>	Prof. Dr. Besa Arifi
3.	<u>Anëtar</u>	Prof. Asoc. Dr. Berat Aqifi

Kandidatët e paraqitur:	Prof. Ass. Dr. Mensur Morina
-------------------------	------------------------------

Të dhënat mbi kandidatin

Emri dhe mbiemri: **MENSUR MORINA**

Datëlindja dhe vendlindja: **01.07.1986, KAMENICË**

Gradat shkencore: **Dr.sc.**

Titujt akademikë: **Prof. Ass. Dr.**

Viti kur është fituar titulli aktual: **2022**

Departamenti/fakulteti: **Fakulteti Juridik**

Universiteti: **Universiteti "Haxhi Zeka"**

1. Edukimi dhe niveli arsimor

(Në këtë pjesë të raportit shënohen universitetet në të cilat ka studiuar kandidati)

Emri i institucionit, Universitetit	Periudha prej- deri	Titulli i fituar	Drejtimi
UNIVERSITETI I EVROPËS JUGLINDORE, MAQEDONISË SË VERIUT	2016 - 2019	Doktor i shkencave Juridike e Drejta Penale	E drejta Penale
UNIVERSITETI HACETTEPE - ANKARA- TURQI	2016 - 2023	Doktora - Adli Bilimler	Doktor i Filozofisë Shkenca të Kriminalistikës "Forenzikë"
KOLEGJI FAMA	2013 - 2014	LLM në Juridik Penale	Juridik-Penale
KOLEGJI FAMA	2009 - 2013	JURIDIK - Kriminalistikë	Kriminalistikë

2. Përvoja e punës (puna jashtë mësimdhënies)

Emri i institucionit	Aktiviteti	Periudha
N.T.P ENAL DECOR	Drejtor Ekzekutivë	2007-2010
OJQ LIZA-R	Drejtor Ekzekutiv	2007- 2026

3. FORMULAR PËR AKTIVITETIN ARSIMOR (MËSIMDHËNIEN)

Tabela I.1. Aktivitetet mësimore, me përqendrim të përvojave relevante
(1 vit baras vlerësohet me 0,50 pikë)

IAL (emri i institucionit/fakulteti)	Periudha kohore e mësimdhënies	Pikët Kjo rubrikë është e rezervuar për Universitetin
UNIVERSITETI I NOVIPAZARIT DEGA NË PRESHEVË	2018/2019 VITI III SEMSTRI DIMROR	0.50

IAL (emri i Institucionit/fakulteti)	Periudha kohore e mësimdhënies	Pikët <i>Kjo rubrikë është e rezervuar për Universitetin</i>
KOLEGJI ARBËRI	2019 VITI IV SEMESTRI DIMORË	0.50
UBT PRISHTINË - BACHELOR	2019 / 2022 SEMESTRI DIMORË DHE VERORË	1.50
UBT - PRISHTINË MASTER	2019 / 2022 SEMESTRI DIMORË DHE VERORË	0.50
UNHZ Fakulteti Juridik	2022 / 2026 Gjatë SEMESTREVE DIMORË DHE VERORË	3

Tabela I.2. Cilësia në mësimdhënie dhe mësimnxënie

(Duhet të llogaritet mesatarja për 3 vite të fundit.)

Aktiviteti	Vlerësimi i aktivitetit	Pikët referente për aktivitet Pikët <i>Kjo rubrikë është e rezervuar për Universitetin</i>
Vlerësimi i mësimdhënies nga studentët 2025/26	4.83	Pozitiv
Vlerësimi i mësimdhënies nga studentët 2023/24	4.74	Pozitiv
Vlerësimi i mësimdhënies nga studentët 2022/23	4.91	Pozitiv

Tabela I.3. Mentorimi për tema në nivelin bachelor, master dhe të doktoratës

(mentorimi, bashkëmentorimi dhe anëtarë i komisionit për mbrojtje në temat e doktoratës)

(Poentimi për mentorim dhe bashkëmentorim: bachelor= 0,20 pikë; master = 0,50 pikë; Doktorata = 1 pikë, Poentim për antarë të komisionit: doktorat= 0,50)

Emri i kandidatit	Emri i Institucionit	Niveli i studimit	Statusi (në proces/përfunduar) Pikët <i>Kjo rubrikë është e rezervuar për Universitetin</i>
Djellza Muzlija	UBT	Përfunduar: 2021	0.20
Arsim Jashari	UBT	Përfunduar: 2022	0.20
Hasan Arifi	UBT	Përfunduar: 2021	0.20
Shkelqim Mustafa	UBT	Përfunduar: 2021	0.50
Jetmir Cuçi	UBT	Përfunduar: 2021	0.20
Laurata Fazlija	UBT	Përfunduar: 2022	0.20
Enver Shala	UBT	Përfunduar: 2021	0.20
Albert Sadiku	UBT	Përfunduar: 2021	0.20

Emri i kandidatit	Emri i institucionit	Niveli i studimit	Statusi (në proces/përfunduar) Pikët Kjo rubrikë është e rezervuar për Universitetin
Elsa Ibrahimli	UBT	Përfunduar: 2022	0.20
Besarta Pireva	UBT	Përfunduar: 2022	0.20
Bashkim Islami	UBT	Përfunduar: 2022	0.20
Granit Gashi	UBT	Përfunduar: 2022	0.50
Barbara Beqiri	UBT	Përfunduar: 2022	0.50
Arbana Elezi	UBT	Përfunduar: 2022	0.50
Fitore Muriqi Haxhasaj	UNHZ	Përfunduar: 2025	0.50
Majlinda Kelmendi	UNHZ	Përfunduar: 2026	0.50
Zyhdë Hajzeri	UNHZ	Në Process: 2025	/
Dardan Tola	UNHZ	Në Process: 2025	/
Aulona Krasniqi	UNHZ	Në Process: 2025	/

Tabela I.4. Pjesëmarrja në aktivitete profesionale

(trajnim, seminare, mobilitete, punëtori, vizata studimore, etj)

Aktiviteti (Përshkrim i shkurtër)	Data / Periudha	Poentimi për aktivitet = 0,50 pikë Pikët Kjo rubrikë është e rezervuar për Universitetin
Universiteti Erbakan në Konya Turqi - Çertifikim	1-10 April 2018	0.50
Inter University center Dubrovnik - Çertifikim	10-16 March 2019	0.50
4th International Summer University 2025	2025	0.50
5th International Summer University 2025	2026	0.50

4. Përvoja në mësimdhënie universitare

Në këtë pjesë të raportit shënohen gradat paraprake shkencore dhe titujt akademikë të kandidatit, si universitetet ku ka punuar ai, si dhe aktivitetet mësimore dhe profesionale: (1 vit barasvlerësohet me 1 pikë)

Emri & niveli i lëndës sipas viteve të perludhës që recensohet	Viti & Semestri kur ligjërohet	Numri i përafërt i studenteve	Numri i orëve për semestër	Forma e mësimdhënies(p.sh., ligjërata, mësim në ekí, tutorim, mbikëqyrje e punës praktike, online, punë në laborator)	Pikët <i>Kjo rubrikë është e rezervuar për Universitetin</i>
UNIVERSITETI I NOVIPAZARIT DEGA NË PRESHEVË E DREJTA PENALE NDËRKOMBËTARE	2018/2019 VITI III SEMSTRI DIMROR	20	3	LIGJERATA, UDHTRIME, SEMINARE, RASTE STUDIMI	1
KOLEGJI ARBËRI	2019 VITI IV SEMSTRI DIMRORË	25	3	LIGJERATA, UDHTRIME, SEMINARE, RASTE STUDIMI, VIZITA STUDIMORE	1

Emri & niveli i lëndës sipas viteve të periudhës që recensohet	Viti & Semestri kur ligjërohet	Numri i përafërt i studenteve	Numri i orëve për semestër	Forma e mësimdhënies(p.sh., ligjërata, mësim në eki, tutorim, mbikëqyrje e punës praktike, online, punë në laborator)	Pikët Kjo rubrikë është e rezervuar për Universitetin
UBT PRISHTINË – BACHELOR E DREJTA PENALE PJESA E PËRGJITHËSHM E DREJTA PENALE PJESA E POSAÇME E DREJTA PENALE NDËRKOMBËT ARE E DREJTA PENALE PËR TË MITUR VIKTIMOLOGJI MJEKËSI LIGJORE LIGJI, ETIKA DHE INDUSTRIA ÇËSHTJET ETIKE DHE LEGALE NË SISTEME TË INFORMACIONIT	2019 / 2022 SEMESTRI DIMORË DHE VERORË	60	10/10	LIGJERATA, UDHTRIME, SEMINARE, RASTE STUDIMI, VIZITA STUDIMORE	3

Emri & niveli i lëndës sipas viteve të periudhës që recensohet	Viti & Semestri kur ligjërohet	Numri i përafërt i studenteve	Numri i orëve për semestër	Forma e mësimdhënies(p.sh., ligjërata, mësim në ekë, tutorim, mbikëqyrje e punës praktike, online, punë në laborator)	Pikët Kjo rubrikë është e rezervuar për Universitetin
UBT - PRISHTINË MASTER KRIMINALISTIK A DHE FORENZIKA APLIKATIVE PROCEDURAT KRIMINALISTIKE PËR KRIME KOMPJUTERIKE E DREJTA PENALE E AVANSUAR LIGJI, ETIKA DHE IMPLIKIMI DIGJITALIZIMIT	2019 / 2022 SEMESTRI DIMORË DHE VERORË	50	10/10	LIGJERATA, UDHTRIME, SEMINARE, RASTE STUDIMI, VIZITA STUDIMORE	

Emri & niveli i lëndës sipas viteve të periudhës që recenzohej	Viti & Semestri kur ligjërohet	Numri i përafërt i studenteve	Numri i orëve për semestër	Forma e mësimdhënies(p.sh., ligjërata, mësim në ekë, tutorim, mbikëqyrje e punës praktike, online, punë në laborator)	Pikët <i>Kjo rubrikë është e rezervuar për Universitetin</i>
UNHZ Fakulteti Juridik 1. E drejta Penale Pjesa Posaqme, 2. Kriminologji- Penologji, 3. Delikuenca e të Miturëve, 4. Mjeksi Ligjore, 5. E drejta e Procedurës Penale, 6. E drejta e Procedurës Penale pjesa e posaqme 7. E Drejta Evropiane dhe Ndërkombëtare e Migracionit	2022 / 2026 Gjatë SEMESTREVE DIMORË DHE VERORË			LIGJERATA, UDHTRIME, SEMINARE, RASTE STUDIMI, VIZITA STUDIMORE	4

5. Përmbledhje e aktivitetit shkencor

a) Punimet shkencore të kandidatit

(Në këtë pjesë të raportit përshkruhen në mënyrë të detajuar publikimet në bazë të të cilave bëhet zgjedhja/avancimi i kandidatit si dhe rëndësia e tyre dhe ndërlidhja me lëndët dhe fushën për të cilat zgjedhet/avancohet kandidati/ja)

Tabela II.1. Publikimet në revista shkencore që plotësojnë kushtet sipas pikës A.2.1 të kësaj Tabele (Publikimet në revista të tilla barasvlerësohen me 1 pikë)

Nr.	Autorët (renditja si në punim) & Titulli i punimit, Revista, Vëllimi, Nr. i faqeve , Viti	Vegëza identifikuese	Pikët Kjo rubrikë është e rezervuar për Universitetin
1	Morina, Mensur, Osmani, Sulejman Curri, Fadil UNJUST PROVOCATION AND INFLUENCE OF GUILT Revista Juridica Scopus 2024	https://www.researchgate.net/publication/385099201_Revista_Juridica_unicuritib_a_UNJUST_PROVOCATION_AND_INFLUENCE_OF_GUILT_PROVOCACAO_INJUSTA_E_INFLUENCIA_DA_CULPA	1
2	Orhan M. Çeku Mensur Morina Florent Azemi Muhammet Ali Eren Importance Of Special Investigation Measures For Uncovering, Investigating And Solving Criminal Offences: Key Factors To The Quality Of A Safety Life Quality - Access to Success Scopus 2023	https://www.researchgate.net/profile/Orhan-Ceku/publication/375165017_Importance_Of_Special_Investigation_Measures_For_Uncovering_Investigating_And_Solving_Criminal_Offences_Key_Factors_To_The_Quality_Of_A_Safety_Life/links/654281623cc79d48c5c68db8/Importance-Of-Special-Investigation-Measures-For-Uncovering-Investigating-And-Solving-Criminal-Offences-Key-Factors-To-The-Quality-Of-A-Safety-Life.pdf	1

Nr.	Autorët (renditja si në punim) & Titulli i punimit, Revista, Vëllimi, Nr. i faqeve , Viti	Vegëza identifikuese	Pikët Kjo rubrikë është e rezervuar për Universitetin
3	Mensur Morina Fadil Curri Armand Krasniqi Florent Azemi THE ROLE OF SOCIAL MEDIA IN THE SPREAD OF EXTREME TERRORISM IN KOSOVO: THE LEGAL AND CRIMINAL VIEW OF THESE CRIMES Journal Human Research in Rehabilitation Scopus 2023	https://human.ba/wpdm-package/full-text-262/?wpdmcl=2011&refresh=6a6dc21f9e70e1785578015	1
4	Mensur Morina Brigita Curri Fadil Curri Treatment Of Rape In Kosovo From 2019 - 2021: Quality Assurance, Legal And Forensic Aspects Quality - Access to Success Scopus 2023	https://www.researchgate.net/profile/Fadil-B-Curri/publication/373069240_Treatment_Of_Rape_In_Kosovo_From_2019_-_2021_Quality_Assurance_Legal_And_Forensic_Aspects/links/64d63932d3e680065a0ec9bb/Treatment-Of-Rape-In-Kosovo-From-2019-2021-Quality-Assurance-Legal-And-Forensic-Aspects.pdf	1

Nr.	Autorët (renditja si në punim) & Titulli i punimit, Revista, Vëllimi, Nr. i faqeve , Viti	Vegëza identifikuese	Pikët Kjo rubrikë është e rezervuar për Universitetin
5	Mensur Morina Florent Azemi Muhammet Ali Eren Ismail Zejnelli Endri Papajorgji Crime Scene in Cybercrime Criminal Offenses: Evidence Management and Processing Academic Journal of Interdisciplinary Studies Scopus 2023	https://d1wqtxis1xzie7.cloudfront.net/112426672/12833-libre.pdf?1710471671=&response-content-disposition=inline%3B+filename%3DCrime_Scene_in_Cybercrime_Criminal_Offenses.pdf&Expires=1785581731&Signature=fZGZJVVDGcgP5dgIMNVWLTAhJmoxl5bT1-zcQKcoO5U-GCcFZ0ANaQhSmDuJldyCytArZUJL9pCDeTfTLwJCQeY-FA2jinishnQjh2nSMooNQx3BAde-KjZlgM1-cH3afUB1CjAhsilbGf8wMoWXXWMvMRzW30Xxi796QKe-oy8me-ngsfloCZtNPBGfIyXbJm2KDm9d8zb470V46OsA1JBM9-onSJDYs2cixNBfH9Xq0GD3dumLEQ-N-S0VecFv8nGtJh4o-rqkgEgvivlwdXzSU4-RUcNWdQJUmp-IdPXyFy23~w44HU2wlvCl1-4BHv0VoriRWclP7d6bivkg_&Key-Pair-Id=APKAJLOHF5GGSLRBV4ZA	1
6	Florent Azemi, Mensur Morina Fatos Haziri Comparative Aspect of the State of Terrorism in the Period of the Covid-19 Pandemic at the Global Level and in Kosovo Kriminalistik Scopus 2023	https://www.kriminalistik.de/86627.htm#Artikel4	1

Nr.	Autorët (renditja si në punim) & Titulli i punimit, Revista, Vëllimi, Nr. i faqeve , Viti	Vegëza identifikuese	Pikët Kjo rubrikë është e rezervuar për Universitetin
7	Liburn Mustafa Mensur Morina Central governance and minority rights: The case of the developing country Corporate Law & Governance Review Scopus 2022	https://d1wqtxts1xzle7.cloudfront.net/97829273/clgrv4j2p7-libre.pdf?1674745252=&response-content-disposition=inline%3B+filename%3DCentral_governance_and_minority_rights_T.pdf&Expires=1785582057&Signature=A3vBkKqfTxOHJ~eIXW4hraKMUMXA0IXREnC4ALYLP0fKLzaYKBlwz6P2JCS4xFD-OM-UYtwlDk1RqASMWUS81q2E5cT71IQpWTCfxPxvUQsMoH0xOCkKsvTdYS-ZeXkun3IKKsubT1OcXhplTvcCBA4uzFxFYgwgYD4fUo1cB1s8il3dbS-gev0GEKLRsF9XTyRnIGuRmn9WPAUU3rH-1kcyhAuGnKseEgILupayCXv41Nm7edqF9TRFV5-Ze9aSl-U86G72eAF0ABOVkuFc1DitmElb1Q3ln0CX6IDQuerpvMH7oZ6LqoiwCed2tzyoRN6Q1mWOeCabLyopI22A_&Key-Pair-Id=APKAJLOHF5GGSLRBV4ZA	1

Nr.	Autorët (renditja si në punim) & Titulli i punimit, Revista, Vëllimi, Nr. i faqeve , Viti	Vegëza identifikuese	Pikët Kjo rubrikë është e rezervuar për Universitetin
8	Mensur Morina, Endri Papajorgji, Muhammet Ali Eren, Adrian Alldema] Evaluation of E-mail Accounts Used in Public Institutions in Turkey Within the Scope of Personal Data Academic Journal of Interdisciplinary Studies Scopus Vol. 11 No. 2 2022 March, Fq 142-154 Scopus	https://d1wqtxts1xzle7.cloudfront.net/86154366/12469-libre.pdf?1652960867=&response-content-disposition=inline%3B+filename%3DEvaluation+of+E+mail+Accounts+Used+in+Public+Institutions+in+Turkey+Within+the+Scope+of+Personal+Data&Expires=1785582081&Signature=QlVpQ43Bxfz3YOfSP1vXFuOSGwpw10lqzZuo9rKO7JKu2HtV3vhrTqUEcS55S78uXoPGYnQ-mEC-VMZReNAObLCHcwXVQ7pRds5sXIZoLSaM3H7T-upAJGfI51F3Wl0tkWzY3eqNA2MYGH-12ttNPlwhdWHlclhWxJg2X0BQE3FH1KmN4mB-QzjEwfDuc2rWb-3mL44QM8PczS-3yOHRyGMpDCEpsA1RXGWaIKkzMaQQalFTBiFndfud-MtEPLczoA1Dyj7u4whLOSWCHpBNNppsyduS-u6NWdGVdDIJ0i2ToqzPis7-Wk3Lu2CMnuyghdoT9jXk9QHOCiQU6IA_&Key-Pair-Id=APKAJLOHF5GGSLRBV4ZA	1

Nr.	Autorët (renditja si në punim) & Titulli i punimit, Revista, Vëllimi, Nr. i faqeve , Viti	Vegëza identifikuese	Pikët Kjo rubrikë është e rezervuar për Universitetin
9	Mensur Morina, Muhammet Ali Eren, Adrian Alidemaaj Juvenile Delinquency with its Social and Criminal Dimensions: The Case of Fushe Kosovo Academic Journal of Interdisciplinary Studies Scopus Vol. 10 No. 6 [2021]: November 202, Fq 285-294 Scopus	https://d1wqtxts1xzle7.cloudfront.net/77251202/12290-libre.pdf?1640341231=&response-content-disposition=inline%3B+filename%3DJuvenile_Delinquency_with_its_Social_and.pdf&Expires=1785582104&Signature=FP7NEwvSfgZiSxuFvQ2lsH2wmxx8JNuKG8xoktNs0TJlm8X-muG6670Z0XoJlCyXs-1xwCllZawqF-plb6rdZdhpluLuzVRveyHIR6LCU-tza9-tjanTlfJ31NkexKxh3S0V3Q3CMo2N1owEzBc1KHGufSz1WsgpmoCc74Qctm7nlAAqvJAH-U-hXvjyMLP5cmFl5UQUIMhebtX8uwvVr9yA2u2BxXmsxDw4DPGeveaj-A4yYa7GNs4IqTyXQifb-s1iatZ6pAfH18Ovew9Ey6ciGRyPT8g9PpGtEJHaKzA2AtMEiAtShp-QWKxCaeR6cEdTzYxlef-Tb7nsk4kdA_&Key-Pair-Id=APKAJLOHF5GGSLRBV4ZA	1

Nr.	Autorët (renditja si në punim) & Titulli i punimit, Revista, Vëllimi, Nr. i faqeve , Viti	Vegëza identifikuese	Pikët Kjo rubrikë është e rezervuar për Universitetin
10	Mensur Morina, Endri Papajorgji, Muhammet Ali Eren Collecting Evidence in Forensic Events and Comparison of the Digital Evidence Practices of Kosovo and Turkey Academic Journal of Interdisciplinary Studies Scopus Vol. 10 No. 5 (2021): September 2021, Fq 45-56 Scopus	https://d1wqtxts1xzle7.cloudfront.net/72956172/12237-libre.pdf?1634506150=&response-content-disposition=inline%3B+filename%3DCollecting_Evidence_in_Forensic_Events_a.pdf&Expires=1785582125&Signature=d2M4r39wO9pDpKLTm86uTli-QnfsHL9~ciwle~Am67pa8hDVseUeGVef10sSVUCyIjsa32~uRtt53ldRlw8aSzth64dC-8Zb5qK018Kei0ZHzPLAGzi8RKirb1n2JIS6bN0leWGtKdRQvRhCVPI3bo4riQOCpKQ6tPebixSiYfryltGsZKGx56GvTXEcJAS3JRkdrNMosI2lsRmDj~LU6LAfpAMjx6lanvslieMYxdD3RNZSirLZjdbGGuKINixUu-7hcJQBnBMYXdAk0-u6R1SE~GbGmlaovUthIC8TiKK2y~jrl8xlfxFqQpb~PTNYWkGZ4P4QQILq~XSxPwZA_&Key-Pair-Id=APKAJLOHF5GGSLRBV4ZA	1

Nr.	Autorët (renditja si në punim) & Titulli i punimit, Revista, Vëllimi, Nr. i faqeve , Viti	Vegëza identifikuese	Pikët Kjo rubrikë është e rezervuar për Universitetin
11	Muhammet Ali Eren, Mensur Morina, Endri Papajorgji Digital Evidence and Prohibitions of Evidence Evaluation Journal of Educational and Social Research Scopus Vol. 11 No. 5 (2021): September 2021, Fq 67-76 Scopus	https://d1wqtxts1xzle7.cloudfront.net/97132454/12217-libre.pdf?1673435179=&response-content-disposition=inline%3B+filename%3DDigital_Evidence_and_Prohibitions_of_Evi.pdf&Expires=1785582147&Signature=AFPGvCP1~wssAFNTrmelyOtOJcm2AeI~DNwyApzZFLP8s2hzMCxV9V6UnFOD8NGCEBAjy2Un1Ds~9mLWlyEdpJWO7T6U4b3~MK8drXhjd14ZUJP73~dYkiKMCaSzsn2Z~Rxe~uwpXo4BWxUJWL3fRi3LWhNyaSlpm~xq9kOmlrDc2tdE3bkarKcB8FFqFd0eA3murj9bnrAm1yZklk6hjCRxlwiaJdsCa8Xfn6Q~vIEJTjC08BLvwBW~BdMacbDfniK5F5sW8ebn~a6YYKIE02bbOpRxhywdsTgX6relUFITick56elExZapgXfm9uQYCXavhCv360BRA~lodPkQ_&Key-Pair-Id=APKAJLOHF5GGSLRBV4ZA	1

- A. Publikimet në revista akademike ose shkencore, ndërkombëtare ose vendore që nuk janë përfshirë në Tabelën II. 1. të kësaj shtojce (në cilësinë e autorit të parë, autorit korrespondent ose bashkautorit)

Tabela II.2. Publikimet në revista tjera shkencore (përjashtimisht publikimet në revista të dyshimta), (Publikimet në revista të tilla barasvlerësohen me 0,10 pikë)

Nr.	Autorët (renditja si në punim) & Titulli i punimit, Revista, Vëllimi, Nr. i faqeve , Viti	Vegëza identifikuese	Pikët Kjo rubrikë është e rezervuar për Universitetin
1	Mensur Morina Violent extremism leading to terrorism European Journal of Economics, Law and Social Sciences Vol. 3 No. 1 January, 2019 Fq 218-235 WORLD CAT	https://www.researchgate.net/profile/Mensur-Morina/publication/338769350_Violent_extremism_leading_to_terrorism/links/5e298e2da6f4cc70a1444ef0/Violent-extremism-leading-to-terrorism.pdf	0,10
2	Mensur Morina; Florent Azemi Political Intelligence Service European Journal of Economics, Law and Social Sciences Vol. 4 No. 1 January, 2020 Fq. 161-169 World Cat	https://www.researchgate.net/publication/338539124_Political_Intelligence_Service	0,10
3	Mensur Morina The legal-criminal aspects of terrorism under the Criminal Code of the Republic of Kosovo and Republic of Macedonia European Journal of Economics, Law and Social Sciences Vol. 3 No. 1 January, 2019 Fq 218-235 WORLD CAT	https://www.researchgate.net/publication/338770052_The_legal-criminal_aspects_of_terrorism_under_the_Criminal_Code_of_the_Republic_of_Kosovo_and_Republic_of_Macedonia	0,10
4	Kestrim Avdimetaj; Mensur Morina Economic Growth and Its Determinants in Countries in Transition. Balkan Journal of interdisciplinary Research Vol 1, No 3 Septembre 2015 World Cat	https://www.researchgate.net/publication/329096325_Economic_Growth_and_Its_Determinants_in_Countries_in_Transition	0,10

Tabela II. 3 Publikimet e monografive, librave, kapitujve të librave, dispensave, përkthimeve.
(baras-vlerësohet me 0,50 pikë, përveç librave që barazvlerësohen me 1 pikë)

Nr.	Autorët (renditja si në punim), Titulli i Punimit, Shtëpia Botuese, Vendi, Viti	Lloji i punimit & Vegëza identifikuese (nëse ka)	Pikët Kjo rubrikë është e rezervuar për Universitetin
1	MENSUR MORINA EKSTREMIZMI I DHUNSHËM NË KOSOVË NË RASTET SPECIFIKE NË PERIUDHËN KOHORE 2014-2017 "	https://repository.seeu.edu.mk/sites/thesis/ThesisSharedDocs/DR_126941.pdf	0.50
2	KRIMI I ORGANIZUAR	https://www.researchgate.net/publication/374617263_KRIMI_I_ORGANIZUAR	1
3	Adli Olaylarda Delil Toplama ve Dijital Delillerin Kosova -Türkiye Uygulamalarının Karşılaştırılması	Hacettepe	0.50

Tabela II.4. Publikimet nga kongreset, konferencat, simpoziumet, seminarët, punëtorit (baras-vlerësohet me 0.35 pikë nëse janë publikuar në platformat e paragrafit A.2.1 të kësaj shtojce; 0.10 pikë për të tjerat).

Nr.	Autorët (renditja si në punim) & Titulli i punimit, Revista, Vëllimi, Nr. i faqeve , Viti	Vegëza identifikuese	Pikët Kjo rubrikë është e rezervuar për Universitetin

Tabela II.5. Ligjëratat-prezantimet gojore shkencore në konferenca, simpoziume, punëtori shkencore dhe në universitete tjera (baras-vlerësohet me 0.20 pikë nëse janë konferenca që publikojnë në platformat e paragrafit A.2.1 të kësaj shtojce; 0.05 pikë për të tjerat).

Nr.	Autorët (renditja si në ligjërate/prezantim) & Titulli i ligjëratës/prezantimit, vendi, viti	Lloji i ligjëratës: konferencë, simpozium, punëtori, universitet, etj.	Pikët <i>Kjo rubrikë është e rezervuar për Universitetin</i>
1	Mensur Morina Legal-Criminal oversight into criminal sanctions for the juvenile https://www.researchgate.net/publication/341165578_Legal-criminal_oversight_into_criminal_sanctions_for_the_juvenile	Seventh international conference on: "Education and social sciences – challenges towards the future. Bialystok – Poland, October 2018	0.05
2	Mensur Morina Kqyrja e vendit të ngjarjes të veprave penale të vrasjeve https://www.researchgate.net/publication/341165558_Kqyrja_e_vendit_te_ngjarjes_te_veprat_penale_t_e_vrasjeve	Sixth international conference on: "Education and social sciences – challenges towards the future. Bialystok – Poland, June 2018)	0.05
3	Mensur Morina Impact of legal and economic measures on the management of global pandemic COVID-19 in the western Balkans https://concovid.org/tr/	International Conference of Covid-19 (CONCOVID) An Interdisciplinary, Analysis: Impact on Health, Economy, Society, and Sustainability, 13 June 2020	0.05
4	Mensur Morina Ritja ekonomike dhe determinatat e saj ne vendet ne tranzicion – Faqe 214/224 Nentor 2015	ACADEMIC JOURNAL of Business, Administration, Law and Social Sciences E-ISSN 2410-8693/ISSN 2410-3918	0.05
5	Mensur Morina Kqyrja e vendit të ngjarjes tek vrasjet	Universiteti i Europës Juglindore Juridiko – Penal, April 2017	0.05

Nr.	Autorët (renditja si në ligjërate/prezantim) & Titulli i ligjëratës/prezantimit, vendi, viti	Lloji i ligjëratës: konferencë, simpozium, punëtori, universitet, etj.	Pikët Kjo rubrikë është e rezervuar për Universitetin
6	K Avdimetaj, M Morina, V Zogaj Tregtimi i obligacioneve në tregjet e kapitalit https://dl.watx1xle7.cloudfront.net/67337157/ICBL_A5_III_Book_of_Proceedings-with-cover-page-v2.pdf?Expires=1657570086&Signature=I2p8FkiuOTDMNuk2llVxhwEZjMlp7TOXXoZUZKAJ3fTE3c6pi5-c5rUWwllxoCNz-UuMlf7mu33OTUyPOQVziXR-NJM3UXCH5Yesz8Na79Y9eJi5tRJQn9mfzz98XoIlbmdPyeAlcviGkmSraDAvXsCCxeFOLLIDQXJQ6DWdJi-oo~qUcKA-mfDvgy-bj~F-W7UYF2u5~ynGnuhlEVR~S9zT7Yp7EPRPoFJsBil69-eZ3lFgxmMJHbaeGh3wgSWUXandhGQclbEqIFK9bRNOFGDdaZm4gTI0GDN2uvX6jmNKXmz6UQ9Uep-7QiXyo4A~lrGwlghm74MKxoNchLA_&Key-Pair-Id=APKAJLOHF5GGSLRBV4ZA#page=102	International Institute for Private- Commercial- and Competition Law (IIPCC) Fq 101-107	0.05
7	MENSUR MORINA ADRIAN ALIDEMAJ Factors that affect In Juvenile Delinquency-The Case of Fushë Kosovë/Kosovo Polje https://knowledgecenter.ubt-uni.net/conference/2020/all_events/187/	DOI 10.33107/ubt-ic.2020.275	0.05
8	Sheqir Kutllovci, Fatmir N Halli, Mensur Morina Policy-making in the context of security and interethnic relations in the Western Balkans	UBT	0.05
9	Afrim Sylja, Visar Hoxha, Mensur Morina Clean air for all-sick building syndrome and EU policy framework	UBT	0.05
10	8Th International Scientific Conference of the Faculty of Law ISCFL 23	Universiteti i Tetovës	0.05
11	7Th International Scientific Conference of the Faculty of Law ISCFL 22	Universiteti i Tetovës	0.05

Tabela II.6. Redaktor/Recensent në revistat akademike apo shkencore
(baras-vlerësohet me 0.10 pikë nëse revistat/konferenca janë në platformat e paragrafit A.2.1 të kësaj shtojce; 0.05 pikë për të tjerat)

Nr.	Kontributi (Redaktor/Recensent/Anëtar Bordit Shkencor)	Autori origjinal i punimit (nëse është rasti)	Titulli i punimit të recensuar	Revista/ Konferenca	Vendi, Viti
1	Anëtar i komitetit shkencor / Recenzues i punimeve shkencore			Konferenca ndërkombëtare e UBT-së për Fakultetin Juridik	2020- 2021
2	Anëtar i komitetit shkencor / Recenzues i konferencës shkencore ndërkombëtare			Universiteti Erbakan – Konya https://kongr.e.erbakan.edu.tr/hukuk-2022/hakkin-da/	2020- 2026
3	Anëtar dhe editor në revistën ndërkombëtare shkencore			Fakulteti Juridik, Universiteti Selçuklu Konya, Turqi https://dergi.park.org.tr/tr/pub/suhfd/board	2026

Tabela III. 7. Shërbimi në lidhje me Fakultetin dhe Universitetin (baras-vlerësohen me 0.01 pikë)

Shërbimi përkatësisht pozita në komitet/komision/ekip	Kohëzgjatja	Përshkrimi i aktivitetit të shërbimit dhe rezultatet	Pikët Kjo rubrikë është e rezervuar për Universitetin
Koordinator i akademisë verore i Fakultetit Juridik në UBT	2021/2022	Përgjegjës për organizimin dhe mbikëqyrjen e akademisë verore	0.01
Koordinator i konferencës shkencore ndërkombëtare të Fakultetit Juridik në UBT	2020/2021	Përgjegjës për organizimin dhe mbikëqyrjen e Konferencës ndërkombëtare në UBT https://conferences.ubt-unl.net/2021/conferences/law/committees/	0.01
Prodekan i Fakultetit Juridik në UBT	2021/ 2022		0.01
Prodekan i fakultetit Juridik në Universitetin Haxhi Zeka	2025-Vazhdon		0.01
Kryetar i KQZ në UHZ	2025/2026		0.01

Shërbimi përkatësisht pozita në komitet/komision/ekip	Kohëzgjatja	Përshkrimi i aktivitetit të shërbimit dhe rezultatet	Pikët Kjo rubrikë është e rezervuar për Universitetin
Anëtar i komisionit për Sigurimin e Cilësisë në nivel Universiteti	2023-Vazhdon		0.01
Antar i grupit për kërkime shkencore në nivel Universiteti	2023-Vazhdon		0.01

A. Shërbimi në lidhje me disiplinën/profesionin tjetër (komisionet e ndryshme vlerësuese dhe të pranimi në kuadër të Fakultetit) (baras-vlerësohen me 0.01 pikë)

Shërbimi përkatësisht pozita në komitet/komision/ekip	Kohëzgjatja	Përshkrimi i aktivitetit të shërbimit dhe rezultatet	Pikët <i>Kjo rubrikë është e rezervuar për Universitetin</i>
Koordinator i kryqit kuq në Gjilan	2000-2006	Koordinator për realizimin e aktiviteteve vulnetare dhe humanitare në këtë organizat	0.01
Kryetar i Rjetit Rinor të Gjilanit	2008-2010	Organizimi i aktiviteteve rinore në komunën e Gjilanit si organizat ombrel e rinisë	0.01
Kryetar i Këshillit të Veprimit Rinor Lokal të Gjilanit	2010-211	Organ këshillëdhënës dhe përfaqësues para institucioneve komunale dhe ndërkombëtare në nivel të Komunës së Gjilanit	0.01
Kryetar i Këshillit Qëndror të Rinisë së Republikës së Kosovës	2011-2014	Organ më i lart përfaqësues rinor i cili rregullon pjesëmarrjen e rinisë në bazë të ligjit Nr. 03/L145	0.01
Drejtor ekzekutivë i organizatës LIZA-R	2006-2026	Aktivitete rinore për lidhshmëri dhe demokratizim të rinisë	0.01

Tabela III.8. Kontribute tjera shkencore dhe profesionale

B. Kontributi në projekte kërkimore dhe të aplikueshme

Tabela II.8. Pjesëmarrja e dëshmuar në projekte kërkimore dhe të aplikueshme (baras-vlerësohet me 0.20 pikë projekte të vogla kërkimore (2000-10000€); projekte ndërkombëtare 0.50 pikë)

Nr.	Titulli i programit/projektit shkencor	Institucioni, Vendi dhe Viti	Pozita/Kontributi në program ose projekt

C. Patente në nivel ndërkombëtar ose kombëtar dhe zbulimet shkencore

Tabela II.9. Patente zyrtare në nivel ndërkombëtar dhe kombëtar (baras-vlerësohen me 1 pikë)

Nr.	Autorët (renditja si në patentën e zyrtarizuar)	Titulli i patentës	Institucioni, vendi, dhe viti i zyrtarizimit

6. Titulli i cili propozohet (Profesor i Asocuar)

(Anëtarët e Komisionit vlerësues janë të obliguar që të shkruajnë një arsyetim të detajuar lidhur me titullin i cili propozohet. Ata janë të obliguar që të paraqesin në mënyrë të qartë arsyet e bazuara në Statut, Rregulloren nr. 025/23 për Procedurat Vlerësuese dhe Përzgjedhëse Lidhur me Emërimin, Riemërimin dhe Avancimin e Personelit Akademik të Rregullit në Universitetin "Haxhi Zeka" në Pejë dhe në Konkurs dhe përse kandidati i përzgjedhur e meriton më shumë se të tjerët që të propozohet).

Komisioni Vlerësues, i themeluar nga Këshilli i Fakultetit Juridik, në këtë përbërje: **Prof. Dr. Ismail Zejneli** - Kryetar; **Prof. Dr. Besa Arifi** - Anëtare; **Prof. Asoc. Dr. Berat Aqifi** - Anëtar

Komisioni Vlerësues, pas shqyrtimit dhe analizimit të dokumentacionit të paraqitur nga kandidati **Prof. Ass. Dr. Mensur Morina**, dhe duke u bazuar në Ligjin nr. 04/L-037 për Arsimin e Lartë, Statutin nr. 04-V-622 të Universitetit "Haxhi Zeka" në Pejë, përkatësisht nenet 170 dhe 172, Rregulloren nr. 025/23 për Procedurat Vlerësuese dhe Përzgjedhëse Lidhur me Emërimin, Riemërimin dhe Avancimin e Personelit Akademik të Rregullit në Universitetin "Haxhi Zeka" në Pejë, përkatësisht nenin 5, Rregulloren për Plotësim dhe Ndryshim të Rregullores nr. 025/23, me ref. nr. 2863/23, datë 03.10.2023, si dhe në bazë të Konkursit për emërimin, riemërimin dhe avancimin e personelit akademik të rregullit në UHZ, me ref. nr. 2128, datë 28.07.2026, konstaton se kandidati **Prof. Ass. Dr. Mensur Morina** i plotëson të gjitha kushtet dhe kriteret ligjore, akademike, profesionale dhe shkencore për avancim në thirrjen akademike "**Profesor i Asociuar**" (**Prof. Asoc. Dr.**)

Në vlerësimin e kualifikimit akademik të kandidatit, Komisioni i kushton rëndësi të veçantë përgatitjes së tij të avancuar dhe multidisiplinare në fushën e së Drejtës Penale dhe Forenzikës.

Prof. Ass. Dr. Mensur Morina ka përfunduar studimet e doktoratës në Universitetin e Evropës Juglindore në Maqedoninë e Veriut, në fushën e së Drejtës Penale, duke fituar gradën Doktor i Shkencave Juridike - E Drejta Penale, ndërsa më tej ka përfunduar edhe studimet e doktoratës në Universitetin Hacettepe në Ankara, Republikën e Turqisë, në fushën e Forenzikës.

Kjo përgatitje e dyfishtë doktrale përbën një veçori të rëndësishme të profilin akademik të kandidatit, pasi ndërthur në mënyrë të drejtpërdrejtë dimensionin juridiko-penal, kriminalistik dhe forenzik. Ky formim i avancuar krijon një bazë të gjerë për trajtimin shkencor dhe akademik të çështjeve bashkëkohore të së drejtës penale, kriminalitetit, provave dhe procedurave të hetimit, si dhe për zhvillimin e një qasjeje ndërdisiplinore në fushat e Kriminologjisë me Penologji dhe Delikuençës së të Miturve.

Kjo përgatitje akademike është në përputhje të drejtpërdrejtë me profilin dhe kërkesat specifike të pozitës së përcaktuar në konkurs, përkatësisht për lëndët E Drejta Penale - Pjesa e Posaçme, Klinika Juridike Penale, Delikuenca e të Miturve dhe Kriminologji me Penologji.

Përputhja ndërmjet kualifikimit shkencor të kandidatit, përvojës së tij mësimore dhe fushës së lëndëve të konkursuara paraqet një element të rëndësishëm në vlerësimin pozitiv të kandidaturës.

Prof. Ass. Dr. Mensur Morina ka dëshmuar përvojë të gjerë dhe të vazhdueshme në mësimdhënien universitare, në institucione të ndryshme të arsimit të lartë, përfshirë Universitetin e Novi Pazarit - Dega në Preshevë, Kolegjin Arbëri, UBT - Prishtinë dhe Universitetin "Haxhi Zeka" në Pejë.

Sipas dokumentacionit të paraqitur, kandidati ka qenë i angazhuar në mësimdhënie universitare që nga viti 2018, ndërsa në UBT ka zhvilluar mësimdhënie në nivelin Bachelor dhe Master gjatë periudhës 2019-2022, kurse në Fakultetin Juridik të Universitetit "Haxhi Zeka" gjatë periudhës 2022-2026.

Veprimtaria e tij mësimore karakterizohet nga përdorimi i formave të ndryshme të mësimdhënies universitare, duke përfshirë ligjëratat, ushtrimet, seminarët, rastet studimore dhe vizitat studimore, me një qasje të orientuar drejt kombinimit të njohurive teorike me zbatimin e tyre praktik.

Në nivelin Master, kandidati ka qenë i angazhuar ndër të tjera në lëndë si Kriminalistika dhe Forenzika Aplikative, Procedurat Kriminalistike për Krime Kompjuterike, E Drejta Penale e Avancuar dhe Ligji, Etika dhe Implikimi i Digjitalizimit, ndërsa në Fakultetin Juridik të UHZ-së ka zhvilluar lëndë të tilla si E Drejta Penale - Pjesa e Posaçme, Kriminologji-Penologji, Delikuenca e të Miturve, Mjekësi Ligjore, E Drejta e Procedurës Penale dhe E Drejta e Procedurës Penale - Pjesa e Posaçme.

Për Komisionin, kjo përvojë paraqet një përputhje të drejtpërdrejtë dhe substanciale ndërmjet përgatitjes akademike të kandidatit dhe nevojave konkrete të Fakultetit Juridik, pasi lëndët në të cilat ai ka përvojë të dëshmuar në mësimdhënie janë drejtpërdrejt të ndërlidhura me lëndët për të cilat kërkohet avancimi.

Për më tepër, përvoja e tij në ndërthurjen e së drejtës penale me kriminalistikën dhe forenzikën i jep mësimdhënies një dimension praktik dhe ndërdisiplinor, veçanërisht të rëndësishëm për formimin profesional të studentëve të drejtësisë.

Një tregues i rëndësishëm i cilësisë së veprimtarisë së tij pedagogjike janë edhe vlerësimet e studentëve për mësimdhënien, të cilat gjatë tri viteve të dokumentuara paraqiten në nivele të larta dhe pozitive: 4.91 për vitin akademik 2022/23, 4.74 për vitin 2023/24 dhe 4.83 për vitin 2025/26. Këto rezultate dëshmojnë për një nivel të qëndrueshëm të cilësisë së mësimdhënies dhe për një qasje pedagogjike të vlerësuar pozitivisht nga studentët.

Përveç përvojës së drejtpërdrejtë në mësimdhënie, kandidati ka dëshmuar edhe përvojë të konsiderueshme në mentorim dhe mbështetje të studentëve në punën akademike dhe kërkimore. Në dosje dokumentohen angazhime në mentorimin e studentëve në nivele të ndryshme të studimit, përfshirë Bachelor dhe Master, duke dëshmuar përfshirje aktive në zhvillimin akademik të studentëve dhe në përgatitjen e tyre profesionale.

Një tjetër dimension i rëndësishëm i profilit të kandidatit është përvoja e tij në drejtimin dhe administrimin akademik, e cila shkon përtej angazhimit individual në mësimdhënie.

Prof. Ass. Dr. Mensur Morina ka ushtruar funksionin e Prodekanit të Fakultetit Juridik në UBT, ndërsa aktualisht është i angazhuar si Prodekan i Fakultetit Juridik në Universitetin "Haxhi Zeka".

Po ashtu, ka ushtruar funksionin e Kryetarit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve në UHZ, si dhe është anëtar i Komisionit për Sigurimin e Cilësisë në nivel universiteti dhe anëtar i grupit për kërkime shkencore në nivel universiteti.

Këto përgjegjësi institucionale dëshmojnë se kandidati nuk ka kontribuar vetëm në procesin e mësimdhënies, por edhe në qeverisjen akademike, sigurimin e cilësisë, zhvillimin institucional dhe avancimin e veprimtarisë kërkimore-shkencore të institucioneve të arsimit të lartë.

Përvoja në pozita drejtuese dhe në struktura akademike përbën një tregues të rëndësishëm të aftësisë së tij për të marrë përgjegjësi institucionale dhe për të kontribuar në zhvillimin e Fakultetit dhe Universitetit.

Në të njëjtën linjë, kandidati ka pasur rol aktiv në organizimin dhe zhvillimin e aktiviteteve akademike me karakter ndërkombëtar. Në UBT, ai ka shërbyer si koordinator i Akademisë Verore të Fakultetit Juridik, si dhe si koordinator i Konferencës Shkencore Ndërkombëtare të Fakultetit Juridik, me përgjegjësi për organizimin dhe koordinimin e këtyre aktiviteteve.

Ndërkaq, në Universitetin "Haxhi Zeka" në Pejë, kandidati ka kontribuar si profesor-ligjërues në Akademinë Verore të organizuar nga Universiteti gjatë viteve 2025 dhe 2026. Ky angazhim i tij në organizimin dhe realizimin e aktiviteteve akademike, si dhe në cilësinë e profesor-ligjëruesit, dëshmon për kontributin e tij në zhvillimin dhe promovimin e veprimtarisë akademike ndërkombëtare.

Gjithashtu, Prof. Ass. Dr. Mensur Morina ka kontribuar në komunitetin shkencor përmes pjesëmarrjes si anëtar i komiteteve shkencore dhe recensent i punimeve shkencore në konferenca ndërkombëtare, përfshirë Konferencën Ndërkombëtare të UBT-së për Fakultetin Juridik dhe aktivitetet shkencore të Universitetit Erbakan në Konya.

Në vitin 2026 është evidentuar edhe si anëtar dhe editor në një revistë ndërkombëtare shkencore të Fakultetit Juridik të Universitetit Selçuklu në Konya, Turqi.

Komisioni vlerëson se këto angazhime në recensim, komitete shkencore, redaktim të revistave dhe organizim të aktiviteteve shkencore ndërkombëtare përbëjnë dëshmi të rëndësishme të integritetit të kandidatit në komunitetin akademik dhe shkencor përtej institucionit të tij amë.

Ato dëshmojnë nivel të caktuar të besimit profesional dhe akademik dhe përfaqësojnë një kontribut të drejtpërdrejtë në cilësinë dhe zhvillimin e veprimtarisë shkencore.

Në aspektin e veprimtarisë kërkimore-shkencore, kandidati ka ndërtuar një profil të konsoliduar, me publikime në revista shkencore ndërkombëtare indeksuara në databaza relevante, përfshirë SCOPUS, në përputhje me kriteret dhe kërkesat e përcaktuara me Statutin, Rregulloren nr. 025/23 dhe aktet tjera normative në fuqi të Universitetit "Haxhi Zeka" në Pejë, të cilat trajtojnë çështje të rëndësishme të së drejtës penale dhe disiplinave të ndërlidhura.

Kjo veprimtari shkencore plotësohet edhe me monografi dhe punime të tjera shkencore, ndër të cilat trajtohen tema të tilla si ekstremizmi i dhunshëm në Kosovë, krimi i organizuar dhe çështjet e mbledhjes së provave dhe provave digjitale në perspektivë krahasuese Kosovë-Turqi.

Tematika e këtyre punimeve paraqet një lidhje të qartë me profilin juridiko-penal të kandidatit dhe me lëndët për të cilat propozohet avancimi.

Në këtë kuadër, Komisioni vlerëson veçanërisht koherencën ndërmjet tri dimensioneve të veprimtarisë së kandidatit: mësimdhënies, kërkimit shkencor dhe angazhimit institucional e profesional.

Kualifikimi i tij në të Drejtën Penale dhe Forenzikë, përvoja në mësimdhënien e lëndëve juridiko-penale dhe forenzike, publikimet shkencore në fusha të ndërlidhura, si dhe përvoja në drejtimin e strukturave akademike dhe profesionale, krijojnë një profil të integruar që i përgjigjet në mënyrë të drejtpërdrejtë kërkesave të pozitës së konkursuar.

Për më tepër, kandidati ka një përvojë të gjatë profesionale jashtë mësimdhënies, përfshirë angazhimin si Drejtor Ekzekutiv i OJQ-së LIZA-R, pozitë të cilën e ka ushtruar për një periudhë të gjatë.

Në këtë kapacitet, si dhe përmes angazhimeve të tjera profesionale dhe institucionale, ai ka udhëhequr dhe koordinuar aktivitete dhe projekte në bashkëpunim me partnerë ndërkombëtarë dhe vendorë. Kjo përvojë i shton profilin e tij akademik një dimension të rëndësishëm praktik dhe menaxherial, duke dëshmuar aftësi në udhëheqje, koordinim, menaxhim të projekteve dhe bashkëpunim ndërinstitucional.

Përgatitja e tij me dy doktoratura në fusha të ndërlidhura me drejtësinë penale dhe forenzikën, përvoja e gjerë universitare, rezultatet e larta të vlerësimit nga studentët, angazhimi në mentorim, përvoja në drejtimin akademik, kontributi në sigurimin e cilësisë dhe kërkimin shkencor, pjesëmarrja në komitete dhe konferenca ndërkombëtare, kontributi si recensent dhe editor shkencor, si dhe veprimtaria e tij kërkimore-shkencore, përbëjnë një tërësi të argumentuar të meritave akademike dhe profesionale.

Komisioni vlerëson se përgatitja akademike, përvoja në mësimdhënien universitare, veprimtaria profesionale dhe shkencore e kandidatit janë në përputhje të plotë me kërkesat dhe kriteret e përcaktuara, si dhe me kërkesat specifike të pozitës dhe lëndëve të përcaktuara në konkurs, përkatësisht: Riemërim/Avancim: 1. Një mësimdhënës për lëndët: E Drejta Penale - Pjesa e Posaçme (O) 3+1, Klinika Juridike Penale (O) 2+2, Delikuenca e të Miturve (Z) 2+1, Kriminologji me Penologji (O) 3+1.

Në tërësi, Komisioni vlerëson se veprimtaria shkencore, profesionale dhe akademike e **Prof. Ass. Dr. Mensur Morinës**, së bashku me përvojën e tij të dëshmuar në punë dhe kontributin në jetën akademike të Universitetit, përmbushin kriteret e përcaktuara me aktet normative në fuqi dhe përbëjnë bazë të mjaftueshme për avancimin e tij në thirrjen akademike "**Profesor i Asociuar**".

Andaj, Komisioni Vlerësues, njëzëri, propozon si më poshtë:

PROPOZIM

